



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LIBRAZH D

Lenda : Raporti I monitorimit te buxhetit per vitin 2018

**DREJTUAR ; MINISTRISE SE FINANCES
DREJTORISE SE BUXHETIT VENDOR
TIRANE**

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, mbështetur në udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr. 2 datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe në zbatim të Ligjit Nr.68 Date 27.04.2017 “Per financat e vetqeverisjes vendore “ po ju sjellim nje raport te realizimit te buxhetit per vitin 2018 .

Per vitin 2018 me V.K.B. Nr. 112 Date 29.12.2017 “Per buxhetin e vitit 2018 dhe programin buxhetor afatmesem 2018 - 2020 “ Bashkia Librazhd ka miratuar fonde per shpenzime nga transferta e pakushtezuar , te ardhurat e veta dhe transferta specifike per 14 programe buxhetore **ne nje vlere totale prej 754,243,199 lekesh**.Programet buxhetore jane si me poshte :

- Planifikim ,Menaxhim dhe Administrim (Administrata dhe Njesite)
- Ujitja dhe Kullimi
- Administrimi I Pyjeve
- Sherbimi Zjarrfikes
- Rruget rurale
- Infrastruktura dhe transporti rrugor.
- Sherbimet Publike (Ndermarrja e sherbimeve dhe Gjelberimit)
- Sherbimi I pastrimit
- Kujdesi Social , Menca Sociale
- Edukimi dhe Sporti (Klubi I Futbollit “SOPOTI “)
- Arti, Kultura dhe turizmi (Qendra Kulturore)
- Arsimi Baze dhe Arsimi Parashkollor
- Arsimi parauniversitar
- Ujesjelles e Kanalizime
- Qendra Ditore e Femijeve me Aftesi te Kufizuar
- Cerdhja e femijeve
- Mbrojtja Sociale (Projekti Tungjatjeta Jete)
- Transporti I mbetjeve urbane
- Fondi rezerve
- Fondi I kontigjences

Synimi kryesor I gjithe punes se bashkise ka qene realizimi I objektivave kryesore te buxhetit te miratuara per vitin 2018 te tilla si :

- Vazhdimin e përmirësimit të ndjeshëm të infrastrukturës rrugore
- Vijimin e investimeve për shtimin sasior dhe cilësor të hapësirave të gjelbërta , si dhe përmirësimin e shërbimeve të tjera publike , që ndikojnë pozitivisht për një rritje cilësore të jetës në qytet.
- Zbatimi i procedurave efektive, për evidentimin e regjistrimit real për çdo taksapagues, dhe maksimizimin e të ardhurave nga Taksat dhe Tarifat vendore, duke rritur ndjeshëm ato nëpërmjet shtimit të bazës së taksapaguesve dhe jo nëpërmjet shtimit të vlerës së taksave.
- Nxitjen e Zhvillimit ekonomik vendor nëpërmjet investimeve kapitale
- Të zgjedhë të kryejë ato shpenzime bazuar në përparësitë dhe prioritetet e komunitetit duke krijuar një ekuilibër të financave të Bashkisë Librazhd

- Vlerësimi i nevojave të Komunitetit përmes dialogut publik dhe caktimin e burimeve aty ku është me e nevojshme duke ndikuar pozitivisht në zhvillimin e ekonomisë.
- Ofrimi i shërbimeve në cdo Njësi Administrative .
- Rritja e transparencës në përdorimin e fondeve publike

Në këtë kuadër Buxheti i Vitit 2018 i Bashkisë Librazhd është realizuar në përputhje dhe në mbështetje të:

- Ligjit 115/2014 datë 31.07.2014 “Për ndarjen Administrative Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë” ndryshuar me Ligjin nr 97/2014
- Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetqeverisjen Vendore ”
- Ligjit Nr 9632 datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligjit Nr 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligjit nr 9936 date 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
- Ligjit nr 9975 datë 28.07.2008, ”Për Taksat Kombëtare”
- Ligjit Nr.68 Date 27.04.2017 “Per financat e vetqeverisjes vendore “
- Ligjit 10405, “Per Kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”
- VKM Nr 165 date 2.03.2016 , “Për grupimin e njesive te qeverisjes vendore per efekt page dhe caktimin e kufijve te pagave per funksionaret e zgjedhur dhe te emeruar , te nepunesve civil e punonjesve administrative te njesive te qeverisjes vendore “ I ndryshuar .
- Udhëzimet përkatëse mbi të Ardhurat
- Udhëzimet përkatëse për zbatimin e Buxhetit
- Vendimet e Keshillit të Bashkisë Librazhd për taksat dhe tarifat vendore si dhe të gjitha vendimet e tjera të Keshillit Bashkiak të marra gjatë vitit 2018 .

Gjatë vitit 2018 , buxheti I miratuar në fillim të vitit ka pasur shtesa në vlerën 13,608,462 leke leke si rezultat i disa investimeve të realizuara në bashkëpunim me Keshillin e Qarkut me një vlerë prej 8,000,000 leke dhe bashkëpunime dhe financime nga shoqata “WORLD VISION “ në vlerën 5,608,462 leke për realizimin e projektit “Tungjatjeta Jete “ dhe investime në arsimin parashkollor .

Të gjitha shtesat dhe ndryshimet e buxhetit të vitit 2018 janë miratuar në Keshillin e Bashkisë dhe janë nxjerrë vendimet përkatëse për këto ndryshime ..

Gjithashtu gjatë vitit 2018 janë bërë me vendim të Keshillit të Bashkisë rishpërndarje të fondeve buxhetore në vlerën 32,412,715 leke

Në total plani i shpenzimeve për vitin 2018 për programet buxhetore e mesipërme pas shtesave të bëra është **767,851,661 leke .**

Realizimi i buxhetit në nivel programi miratuar me V.K.B. Nr.112 Date 29.12.2017 për periudhën Janar- Dhjetor 2018 si më sipër jepet në tabelën si më poshtë :

Nr.	Emertimi I Programit	Buxheti në fillim të vitit 2018	Shtesa	Pakesime	Buxheti me ndrysh.	Ne leke	
						Fakti i Vitit 2018	Realizimi në % Viti 2018
1.	Planifikim Menaxhim Administrimi	189,644,338	4,005,855		193,650,193	148,500,399	76.7
2.	Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit	41,540,927	2,469,375		44,010,302	38,228,029	86.9
3.	Administrimi I pyjeve dhe kullotave	20,861,274	2,432,283		23,293,557	8,662,519	37.2
4.	Sherbimi I mbrojtjes ndaj zjarrit	22,468,813	0	40,080	22,428,733	15,370,605	68.5
5.	Menaxhimi I Rrugeve Rurale	70,291,736	2,000,000		72,291,736	45,981,029	63.6
6.	Menaxhimi I Transportit Rrugor	94,547,086	1,111,109		95,658,195	85,606,673	89.5
7.	Sherbimet publike vendore Ndermarrja e Sherbimeve	47,964,511	3,821,951		51,786,4620	37,648,306	72.7

8.	Sherbimi I pastrimit	18,362,000	0		18,362,000	15,957,925	86.9
9.	Menca Sociale	6,031,808	0		6,031,808	4,282,837	71.0
10.	Zhvillimi I Sportit	34,536,419	21,487,227		56,023,646	47,953,924	85.6
11.	Arti dhe Kultura	17,535,000	620,000		18,155,000	16,368,963	90.2
12.	Arsimi baze (perfshi dhe parashkollorin)	123,167,123		8,215,392	114,951,731	103,053,475	89.6
13.	Arsimi mesem I pergjithshem	3,076,687	2,823,640		5,900,327	3,013,214	51.1
14.	Ujesjelles e kanalizime	23,175,477	0	2,432,283	20,743,194	16,113,965	77.7
15.	Qendra ditore e Femijeve me Aftesi te kufizuar	2,801,000	0		2,801,000	2,146,197	76.6
16.	Cerdhja e femijeve	12,604,000	0		12,604,000	11,895,416	94.4
17.	Projekti Tungjatjete Jete	0	3,513,720		3,513,720	2,525,977	71.9
18.	Transporti I mbetjeve urbane	0	1,736,017		1,736,017	0	0.0
19.	Fondi rezerve	22,635,000		21,724,960	910,040	0	0.0
20.	Fondi I kontigjences	3,000,000			3,000,000	0	0.0
	TOTALI	754,243,199	46,021,177	32,412,715	767,851,661	603,309,453	78.6

Pra sic shihet edhe nga tabela me siper Buxheti Vendor me fondet e vet ate bashkise per 20 programe buxhetore eshte realizuar ne vleren 603,309,453 leke ose 78,67% e planit vjetor .

Gjithashtu per vitin 2018, per periudhen janar-dhjetor jane alokuar fonde nga buxheti i shtetit per 8 programe buxhetore me nje vlere totale prej **908,981,899 leke** leke pas shtesave dhe ndryshimeve te bera gjate vitit. Programet buxhetore jane si me poshte :

- Planifikim , Menaxhim dhe Administrim (Sherbimi i sportelit te Q.K.B-se)
- Planifikim , Menaxhim dhe Administrim (Sherbimi i Gjendjes civile te Bashkise dhe Njesive Administrative
- Sherbimi social per pagesen e ndihmes ekonomike dhe aftesise se kufizuar
- Investime per infrastrukturen Rrugore
- Investime ne sport
- Ujesjelles e Kanalizime
- Investime ne Arsimin e mesem
- Investime per strehimin dhe Bonusi i strehimit

Nr.	Emertimi I Programit	Buxheti ne fillim te vitit 2018	Shtesa	Pakesime	Buxheti me ndrysh.	Fakti Viti 2018	Realizimi ne %
1.	Planifikim , Menaxhim dhe Administrim (Sherbimi I sportelit te Q.K.B-se)	1,146,000	442,000		1,588,000	1,350,592.0	85
2.	Planifikim , Menaxhim dhe Administrim (Sherbimi I Gjendjes civile te Bashkise dhe Njesive Administrative	6,530,698	1,070,000		7,600,698	7,590,202	100
3.	Sherbimi social per pagesen e ndihmes ekonomike dhe aftesise se kufizuar	495,395,000 .0	0		495,395,000 .0	481,638,979 .0	97

4.	Investime per infrastrukturen Rrugore	148,727,234	0	148,727,234	137,210,209	92
5.	Investime ne sport		25,474,6330	25,474,633	24,200,900	90
6.	Ujesjelles e Kanalizime	181,943,249		181,943,249	164,312,864	95
7.	Investime ne Arsimin e mesem	0.0	20,330,210	20,330,210	16,344,628	80
8.	Investime ne Strehim dhe Bonus strehimi	14,909,322	0	14,909,322. 0	14,010,891.	94
9.	5% te Paguar gjate vitit 2018	13,013,553	0	13,013,553	13,013,553.	100
	Totali I buxhetit te Kushtezuar	861,665,056	47,316,843	908,981,899	859,672,818	94,6 %

Buxheti nga transferta e kushtezuar e buxhetit te shtetit per nente programe buxhetore eshte realizuar ne vleren 859,672,818 leke apo 94,6 % e planit vjetor .

Ne total realizimi I buxhetit te Bashkise Librazhd dhe Institucioneve te varesise nga te gjitha burimet e financimit eshte 1,462,982,271 leke apo 87,2% e planit vjetor .


I.TOTALI I BURIMEVE

Nr.	EMERTIMI I BURIMEVE	PLAN
1.	Transferta e Kushtezuar	895,968,346
2.	Transferta e Pakushtezuar	268,864,661
3.	Transferta specifike	131,074,532
4.	Te ardhurat	127,559,462
5.	Te ardhurat e trasheguara	240,353,006
6.	Mjete nen ruajtje	13,013,553
	TOTALI I BURIMEVE	1,676,833,560


II.TOTALI I SHPENZIMEVE

Nr.	EMERTIMI I SHPENZIMEVE	FAKT
1.	Transferta e Kushtezuar dhe f	846,659,265
2.	Transferta ePakushtezuar	200,822,308
3.	Transferta specifike	119,126,560
4.	Te ardhurat	72,909,152
5.	Te ardhurat e trasheguara	210,451,341
6.	Mjete nen ruajtje	13,013,553
	TOTALI I SHPENZIMEVE	1,462,982,179
a.	Shpenzime korente	857,834,923
b.	Shpenzime kapitale	605,147,256


Paraqitja grafike e burimeve te financimit per vitin 2018



Paraqitja grafike e realizimit te shpenzimeve sipas burimeve te financimit



Paraqitja grafike e realizimit te shpenzimeve korente dhe kapitale per vitin 2018



Realizimi I shpenzimeve korente per vitin 2018 eshte ne vleren 857,834 mije leke apo me nje peshe specifike prej 58,6 % ndaj totalit te shpenzimeve ndersa shpenzimet kapitale jane realizuar ne vleren 605,147 mije leke dhe zene nje peshe specifike ndaj totalit te shpenzimeve prej 41,4%


KRAHASIMI I BUXHETEVE 2016-2017-2018

Ne total buxheti I vitit 2018 pavaresisht burimeve te financimit ka qene planifikuar ne vleren 1,676,835,578 leke apo 214,772 mije leke me shume se viti 2016 dhe 78,113 mije leke me teper se viti 2017
Ndersa realizimi I buxhetit per vitin 2018 eshte 458,793 mije leke me teper se realizimi I vitit 2016 dhe 251,722 mije leke me teper se realizimi I vitit 2017 .

Me poshte po japim te dhenat per burimet dhe shpenzimet e vitit 2016-2017-2018 per te bere krahasimin midis ketyre viteve
Ne Leke

		BUXHETI	BUXHETI	BUXHETI
I.	BURIMET E FINANCIMIT	2016	2017	2018
1	Transferta e Kushtezuar	726,660,085	709,589,653	668,220,254
2	Transferta ePakushtezuar	179,886,918	245,220,102	268,864,661
3	Transferta specifike	109,468,752	123,055,095	131,074,532
4	Te ardhurat	80,450,000	97,475,937	127,559,462
5	Te ardhurat e trasheguara	58,524,730.00	304,147,447	240,353,006
6	Mjete nen ruajtje	719,170	172,301	13,013,553
7	Fondet e Zhvillimit te Rajoneve	306,353,596	119,061,604	227,748,092
	Totali I Burimeve	1,462,063,251	1,598,722,139	1,676,833,560
II.	SHPENZIMET	2016	2017	2018
1	Shpenzime per paga	157,417,558	191,755,966	210,046,640.0
2	Shpenzime per sigurime	26,065,688	31,481,329	34,825,594.0
3	Shpenzime operative	69,074,373	81,884,780	107,577,832.
4	Transferime	10,200,833	11,963,050	17,669,798.
5	Ndihma ek.	429,460,593	492,518,907	487,715,061
6	Investime	311,969,657	401,656,385	605,147,256
	TOTALI I SHPENZIMEVE	1,004,188,702	1,211,260,417	1,462,982,271

Sic shihet eshte nga tabela me siper vihet se pothuajse te gjitha burimet e financimit vijne me nje trend rrites nga viti ne vit paraqitur grafikisht si me poshte :



Ndersa realizimi I shpenzimeve per vitin 2018 eshte ne vleren 251,722 mije leke me teper se viti 2017 si rezultat :


- Rritja e realizimit te shpenzimeve nga pagat ne vleren 18,290 mije leke
- Rritja e realizimit te shpenzimeve per sigurimet ne vleren 3,344 mije leke
- Rritja e shpenzimeve operative ne vleren 25,693 mije leke
- Pakesim te shpenzimeve per ndihmen ekonomike ne vleren 4,503 mije leke
- Rritja e shpenzimeve per investime ne vleren 203,491 mije leke

Sic shihet rritja me e madhe tek shpenzimet eshte tek shpenzimet per investime ne masen 80,8 % te totalit te rritjes .


Rritja e shpenzimeve per paga dhe sigurime shoqerore per vitin 2018 vjen si rezultat I rritjes se shpenzimeve per paga per efekt te pageses se vjetersise per punonjesit me arsim te mesem si dhe rritjes se pagave me vendim te keshillit te bashkise per vitin 2018 per punetoret, gje qe ka sjell edhe rritjen e shpenzimeve per kete ze shpenzimesh .Kjo rritje e pagave automatikisht ka sjelle edhe rritjen e shpenzimeve per sigurime shoqerore , pasi llogaritja e sigurimeve behet mbi totalin e pagave bruto .

Kemi nje rritje te shpenzimeve operative krahasuar me vitin 2017 ne vleren 25,693 mije leke pasi ne vitin 2018 jane likujduar 16,000 mije leke shpenzime operative te mbetura pa likujduar nga viti 2017 per shkak te vendosjes se limitit te shpenzimeve nga Ministria e Finances gjate muajve - nentor dhjetor 2017 , duke shtuar ne kete menyre artificialisht shpenzimet operative per vitin 2018.

Paraqitaja grafike e burimeve te financimit per vitet 2016-2017-2018 jepet si me poshte



Paraqitja grafike e realizimit te shpenzimeve 2016-2017-2018 jepet si me poshte :



REALIZIMI I BUXHETIT NGA TRANSFERTA E KUSHTEZUAR

Ne buxhetin nga Transferta e kushtezuar perfshihen te gjitha fondet e akorduara nga Buxheti i shtetit per funksionet e deleguara dhe me destinacion te percaktuar .Keto fonde perdoren vetem per funksionin per te cilin jane akorduar dhe nuk trashegohen ne vitin pasardhes .

Sic jepet edhe ne tabelen me sipër totali i fondeve te akorduara nga buxheti i shtetit per funksionet e deleguara per vitin 2018 eshte 895,968,346 leke dhe realizimi eshte 846,659,265 leke apo 94,6 % e planit vjetor .Ne keto fonde jane perfshire edhe fondet per investimet e perfutuara nga Fondi I Zhvillimit Rajonal qe per vitin 2018 jane ne vleren 227,748 mije leke

Le te shohim me radhe se cilat funksione perfshihen ne buxhetin e transfertes se kushtezuar dhe realizimin e tyre .

Ne buxhetin nga transferta e kushtezuar perfshihet pagesa e punonjesve te Q.K.B-se dhe sporteleve te gjendjes civile prane bashkise Librazhd dhe njesive administrative ne varesi te saj per paga sigurime shoqerore e shpenzime te tjera operative .Numri i punonjesve te Q.K.B-se eshte 2 punonjes , ndersa numri i punonjesve te sherbimit te gjendjes civile eshte gjithsej 6 punonjes .

Realizimi i buxhetit per sherbimin e Q.K.B. se per vitin 2018 eshte 1,350,592 leke apo 85 % e planit vjetor . Realizimi i buxhetit per sherbimin e gjendjes civile per vitin 2018 eshte 7,590,202 leke apo 99,9% e planit vjetor .

Per vitin 2018 jane akorduar fonde per dhenie shperblime lindjesh per regjistrimin ne afat te femijeve ne vleren 770,000 leke , nga ku jane paguar shperblimet per 154 femije te lindur ne vitin 2016 ne Bashkine Librazhd dhe ne 6 Njesite Administrative .

Aktualisht kane mbetur pa dhene nje pjese e shperblimeve te vitit 2016 , viti 2017 dhe 2018 plotesisht .Nga ana jone jane derguar shkresat ne Ministrine e Brendshme per akordimin e fondeve per dhenien e shperblimeve per regjistrim ne afat per periudhen e mbetur te vitit 2016 dhe per vitin 2017 dhe 2018

Gjithashtu per vitin 2018 jane akorduar 1,754,684 leke nga Ministria e Brendshme si demshperblim per 3 familje te demtuara nga fatkeqsite natyrore,banore te njesise administrative Hotolisht .

Me hollsisht realizimi i buxhetit per sherbimin e Q.K.B-se dhe gjendjes civile per periudhen janar-dhjetor 2018 paraqitet ne tabelen me poshte :

Nr.	Emertimi I shpenzimeve	Plani 2018	Fakti 2018	Realizimi ne % Viti 2018	Nr.i punonjesve te miratuar	Nr. I punonj. Te paguar
I.	Shpenzime per Q.K.B				2	2
a.	Shpenzime per paga	1,309,000.0	1,105,907.0	84.5		
b.	Shpenzime per sigurime	219,000.0	184,685.0	84.3		
c.	Shpenzime operative	60,000.0	60,000.0	100.0		
	Totali I Shpenzimeve per Q.K.B.	1,588,000.0	1,350,592.0	85		
II.	Shpenzime per Gjendjen Civile				6	6
	Shpenzime per paga	3,743,000	3,743,000	100		
	Shpenzime per sigurime	590,000	579,504	99,9		
	Shpenzime operative	0	0	0		
	Emergjencat Civile	1,754,684	1,754,684	100		
	Shperblime lindje per regjistrim ne afat	770,000	770,000	100		
	Pullat e Gjendjes civile	743,014	743,014	100		
	Totali I shpenzimeve te gjendjes civile	7,600,698.0	7,590,202.0	99,9		

Githashtu per vitin 2018 nga transferta e kushtezuar eshte bere pagesa e ndihmes ekonomike dhe aftesise se kufizuar ne nje vlere totale prej 481,639 mije leke apo 97,2 % e planit vjetor

Numri mesatar i familjeve te trajtuara me ndihme ekonomike gjate vitit 2018 per Bashkine Librazhd dhe Njesite Administrative te saj ka qene 3,029 familje, i detajuar si me poshte

Bashkia Librazhd	183 familje
Njesia Hotolisht	632familje
Njesia Polis	549 familje
Njesia Qender	788 familje
Njesia Lunik	288 familje
Njesia Stebleve	50 familje
Njesia Orenje	539familje

Numri mesatar i pesronave qe jane trajtuar me pagese paaftesie per bashkine Librazhd dhe Njesite Administrative 2756 persona nga ku 1528persona trajtohen me pagese paaftesie dhe 1238 persona trajtohen me pagese si invalide pune .

Shperndarja e numrit te personave qe trajtohen me pagese aftesie te kufizuar eshte si me poshte :

Bashkia Librazhd	676 persona
Njesia Hotolisht	512 persona
Njesia Polis	322 persona
Njesia Qender	679 persona
Njesia Lunik	184persona
Njesia Stebleve	47 persona
Njesia Orenje	336 persona

Vlen te permendet qe pagesa e ndihmes ekonomike dhe aftesia e kufizuar eshte paguar ne kohe dhe pa problem .Gjithshtu per kete shtrese eshte paguar dhe shperblimi i akorduar ne fund te vitit ne perputhje me Vendimin e Keshillit te Ministrave .

Nese bejme krahasimin midis fondeve te akorduara nga buxheti i shtetit per shpenzime korente me shpenzimet kapitale , veme re qe fondet per shpenzimet kapitale perbejne 38 % te fondeve totale te alokuara nga buxheti i shtetit dhe realizimi i investimeve eshte ne masen 26,3% e totali te shpenzimeve te realizuara nga transferta e kushtezuar .

Le te bejme nje krahasim te realizimit te transertes se kushtezuar ne vitin 2016 – 2017-2018 :

	BURIMET E FINANCIMIT	PLAN 2016	FAKT 2016	PLAN 2017	FAKT 2017	PLANI 2018	FAKTI 2018
1	Transferta e kushtezuar	726,660,085	505,052,750	828,823,538	691,522,807	895,968,346	846,659,265
a	Shpenzime korente	471,808,781	453,353,541	512,743,835	509,934,209	505,993,182	491,773,257
b	Shpenzime kapitale	254,851,304	51,699,209	316,079,703	181,588,598	389,975,164	354,886,008

Pra sic shihet edhe nga tabela me sipër kemi një rritje të planit të viti 2018 krahasuar me vitin 2017 me 67,144 mijë leke si dhe një rritje të realizimit të shpenzimeve prej 155,136 mijë lekesh. Vlen të përmendet se investimet për vitin 2018 paraqiten me një rritje prej 73,895 mijë lekesh si plan dhe me një rritje prej 208,386 mijë leke me shumë si fakt .

Realizimi i investimeve nga transferata e kushtezuar për vitin 2018 është në vlerën 354,886,008 leke apo 91% e planit vjetor. Kryesisht janë investime që kanë të bëjnë me infrastrukturën rrugore, ujësjellës e kanalizime , investime në arsim dhe investime në programin e strehimit .

Le të shohim në mënyrë të detajuar realizimin e këtyre investimeve :

Nr	Lloji i investimit	Nga Buxheti i Shtetit	Financimi 2018	Realizimi ne %	Komente
1.	Furnizimi me uje I fh.Dorez-Gizavesh,L.Katund,-L.Qender 0 6 01 06370 231	63,935,855	60,730,062	95	Perfunduar eshte marre ne dorezim
2.	Mbikqyrje per objektin Furnizimi me uje I fh.Dorez-Gizavesh,L.Katund,-L.Qender 0 6 01 06370 231	470,794	470,794	100	Perfunduar
3.	Ndertimi I rrjetit shperndares Dorez ,Gizavesh 06 06370 1 231 M063802	83,456,610	75,145,378	90	Perfunduar eshte marre ne dorezim
4.	Supervizim per objektin Ndertim I rrjetit shperndares Dorez ,Gizavesh	863,975	863,975	100	Perfunduar eshte marre ne dorezim
5	Permirsim I kushteve te banimit te komunitetit rom	13,499,838	12,817,407	95	Perfunduar ne process marrje dorezimi
I.	Totali I investimeve nga Buxheti I shtetit	162,227,072	150,027,616	92,5	
1	Rikualifikimi urban Blloku I banimit Nr.1	59,909,989	56,914,489	95	Perfunduar eshte marre ne dorezim
2.	Rehabilitim I zones ne te dyja anet e rruges ,Rruga e Dibres	92,400,449	87,780,426	95	Perfunduar eshte marre ne dorezim
3.	Rikualifikimi urban I zones ne hyrje te qytetit dhe mbrojtje lumore	29,632,811	19,617,949	66	Perfunduar eshte marre ne dorezim
4	Rikonstruksion I shkolles se mesme Hotolisht 11 01 08140	25,474,633	24,200,900	95	Ne process zbatimi
5	Rik.dhe shtese anesore sh.mesme Isa Alla Zgosht 11 01 09120	20,330,210	16,344,628	80	Ne processzbatimi
II.	Totali I investimeve nga Fondet e Rajoneve	227,748,092	204,858,392	89,9	
	Totali I investimeve nga Buxheti I Shtetit (I+II)	389,975,164	354,886,008	91	

Pervec investimit “Rikonstruksion I shkolles se mesme Hotolisht “ dhe “Rikonstruksion dhe shtese anesore shkolle .mesme “Isa Alla Zgosht “ qe jane investim ne process , te gjitha investimet e tjera me burim financimi nga buxheti i shtetit dhe fondet e rajoneve jane te perfunduara dhe jane marre ne dorezim .
 Per te gjitha investimet e mesiperme eshte bere ngurtesimi i fondeve ne masen 5% te situacioneve te kaluara , si garanci per difektet e mundshme , ne perputhje me kontratat e nenshkruara mes paleve .
 Ne total fondi i ngurtesuar per 5% e garancise se punimeve per investimet e mesiperme eshte 19,066,599 leke .
 Duke marre parasysh dhe fondin e ngurtesuar per 5% e garancise realizimi I investimeve nga buxheti I shtetit dhe fondet e rajoneve arrin realisht ne masen 96% , nje tregues ky mjaft I kenaqshem

REALIZIMI I BUXHETIT VENDOR

Ne buxhetin vendor perfshihen burimet e financimit nga :

- Transferta e Pakushtezuar
- Transferta Specifike
- Te ardhurat e veta
- Te ardhurat e Trasheguara

Te gjitha keto burime financimi ashtu sic eshte percaktuar ne Ligjin 139/2015 “Per vetqeverisjen vendore “ perdoren nga pushteti vendor per realizimin e funksioneve te veta , funksioneve specifike dhe funksioneve te perbashketa .

Fondet nga burimet e mesiperme te financimit jane fonde te cilat perdoren me Vendim te keshillit te Bashkise , sipas projektit te paraqitur nga bashkia .Ne ndryshim nga fondet e kushtezuara te cilat vijne me destinacion te percaktuar , burimet e financimit te buxhetit vendor perdoren sipas nevojave dhe prioriteteve te percaktuara nga Bashkia per plotesimin e funksioneve te veta dhe funksioneve te perbashketa .Fondet e shpenzuar ne fund te vitit nga burimet e mesiperme jane fonde qe trashegohen dhe mund te perdoren ne buxhetin e vitit pasardhes.
 Buxheti vendor eshte nje buxhet I balancuar midis te ardhurave dhe shpenzimeve , ashtu sic eshte percaktuar ne Ligjin e Buxhetit dhe Ligjin “Per vetqeverisjen vendore “

Realizimi I buxhetit te Bashkise sipas burimeve per vitin 2018

Nr.	EMERTIMI I BURIMEVE	PLAN 2018	REALIZIMI 2018
2.	Transferta e Pakushtezuar	268,864,661	200,822,308
3.	Transferta specifike	131,074,532	119,126,560
4.	Te ardhurat	127,559,462	72,909,152
5.	Te ardhurat e trasheguara	240,353,006	210,451,341
	TOTALI I BURIMEVE	767,851,661	603,309,361

Realizimi I buxhetit vendor ne vite jepet ne tabelen si me poshte :

I.	BURIMET E FINANCIMIT	PLANI 2016	PLANI 2017	PLANI 2018
2	Transferta ePakushtezuar	179,886,918	245,220,102	268,864,661
3	Transferta specifike	109,468,752	123,055,095	131,074,532
4	Te ardhurat	80,450,000	97,475,937	127,559,462

5	Te ardhurat e trasheguara	58,524,730.00	304,147,447	240,353,006
	Totali I Burimeve	428,332,416	769,898,581	767,851,661
II.	SHPENZIMET	2016	2017	2018
1	Shpenzime per paga	152,941,321	186,973,862	205,197,733.0
2	Shpenzime per sigurime	25,308,285	30,717,587	34,061,405.0
3	Shpenzime operative	57,750,019	71,077,805	107,517,832.0
4	Transferime	2,865,879	10,967,850	19,284,698.0
5	Investime	79,220,015	220,072,787	237,247,786
	TOTALI I SHPENZIMEVE	318,085,519	519,809,891	603,309,361

Ne pamje te pare duket sikur kemi ulje te burimeve te financimit per vitin 2018 ne vleren 2,046,920 leke por ne fakt pot e shikojme me kujdes veme re se te gjitha transfertat rezultojne me rritje ne vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 .Vetem te ardhurat e trasheguara jane me ulje krahasuar me vitin 2018 ne vleren 63,794,441 leke duke ndikuar ne kete menyre ne totalin e burimeve te krahasuar midis viteve 2017-2018 .

Me qarte diferencat e burimeve te financimit per vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 jane si me poshte :

- Rritje te transfertes se pakushtezuar ne vleren 23,644,559 leke
- Rritje te transfertes specifike ne vleren 8,019,437 leke
- Rritje te te ardhurave te veta ne vleren 30,083,525 leke
- Ulje te te ardhurave te trasheguara -63,794,441 leke

Shpenzimet per vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 kane pesuar nje rritje me 83,499,562 leke sipas artikujve te shpenzimeve si me poshte :

- Rritje te shpenzimeve per paga ne vleren 18,223,871 leke
- Rritje te shpenzimeve per sigurime ne vleren 3,343,818 leke
- Rritje te shpenzimeve operative ne vleren 36,440,027 leke
- Rritje te shpenzimeve per investime ne vleren 17,174,998 leke
- Rritje te shpenzimeve per transferime ne vleren 8,316,818 leke

MONITORIMI I SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE

❖ PROGRAMI I ADMINISTRATËS VENDORE 0 0 1 1110 (PLANIFIKIM, MENAXHIM ADMINISTRIM)

Ky program ka te beje me menaxhimin financiar të Bashkisë Librazhd dhe përfshin shpenzimet e nevojshme administrative për funksionimin normal të administratës vendore dhe përmbushjen e misionit të bashkisë për mobilizimin dhe përdorimin me efikasitet dhe efektivitet të burimeve financiare publike, për realizimin e qëllimeve dhe objektivave,

Realizimi i shpenzimeve per Administraten per vitin 2018 jepet ne tabelen si me poshte :

Ne leke

Nr.	Emertimi I shpenzimeve	Plani 2018	Fakti 2018	Realizimi ne %	Nr.i punonj.sipas V.K.B.	Nr. I punonj. Te paguar
I.	Shpenzime per pagat				127	104
a.	Nga Transfera e Pakushtezuar	46,842,000	46,827,531			
b.	Ng ate ardhurat	30,000,000	17,762,969			
c.	Nga te trasheguarat	0	0	0		
	Totali I (Pagat)	76,842,000	64,590,500	84		
II.	Shpenzime per sig.shoqerore				128	113

a.	Nga Transfera e Pakushtezuar	7,548,747	7,140,394		
b.	Nga te ardhurat	5,000,000	3,594,815		
c.	Nga te trashëguarat	0	0		
	Totali II. (Sig.shoqerore)	12,548,747	10,735,209	85,5	
III.	Shpenzime operative				
a.	Nga Transfera e Pakushtezuar	24,612,728	21,068,637		
b.	Nga te ardhurat	12,672,272	10,001,640		
c.	Nga te trashëguarat				
	Totali III (shpenzime operative)	37,285,000	31,070,277	83	
IV.	Investimet				
a.	Nga Transfera e Pakushtezuar	18,099,515	3,440,203		
b.	Nga te ardhurat	8,000,000	1,382,145		
c.	Nga te trashëguarat	29,972,125	26,597,367		
	Totali III (Investimet)	56,071,640.0	31,419,715.0	56	
5.	Transferime K.Qarkut +Tatimet (Te ardhurat)	6,004,470	6,004,470	100	
6	Bursa studenteve +Bonus strehimi Grant	4,330,580	4,112,598	94,5	
7	Transferime Grant	567,756	567,630	100	
	TOTALI	193,650,193	148,500,399	76,7	

Numri I punonjesve te planifikuar ne buxhetin e vitit 2018 per bashkine dhe Njesite Administrative ka qene 128 punonjes.Numri mesatar I punonjesve te paguar per vitin 2018 ka qene 104 punonjes ,.

Pagesa e punonjesve te miratuar me V.K.B.Nr.110 Date 29.12.2017 “Per miratimin e numrit maksimal te punonjesve te Bashkise Librazhd “eshte bere ne perputhje me V.K.B. Nr.111 Date 29.12.2017 “Per klasifikimin e kategorizimin e pagave te Bashkise dhe institucioneve ne varesi te saj “ .

Pagesa per kontribute shoqerore e shendetsore eshte bere ne masen 16,7% ashtu sic eshte e percaktuar edhe ne ligjin per pagesen e kontributeve te sigurimeve shoqerore e shendetsore.

Sic shihet edhe nga tabela me siper realizimi I buxhetit per per programin e planifikimit , menaxhimit dhe administrimit per viti 2018 eshte realizuar ne vleren 148,500,399 leke leke ose 76,7 % e planit vjetor .

Mosrealizimi I buxhetit per programin “Adminstrim,Planiikim “ eshte ne vleren 45,179,794 leke ose 23,3% per arsyet si me poshte :

1. **Mosrealizimi I fondit te pagave ne vleren 12,251,500 leke apo masen 16% te planit vjetor** si rrjedhoje e mosplotesimit te organikes se Administrates se Bashkise dhe Njesive administrative me numrin e planifikuar te punonjesve .Keshtu per vitin 2018 numri total I punonjesve te planifikuar per programin administrim planifikim ne momentin e hartimit te buxhetit te vitit 2018 ka qene 128 punonjes , nderkohe qe per vitin 2018 jane paguar faktikisht 113 punonjes pra 15 punonjes me pak qe sjell nje mosrealizim te fondit te pagave prej 7,465 mije leke dhe mosshperndarja e fondit te vecante te planifikuar ne vleren **4,786 mije leke.**
2. **Mosrealizim I fondit te sigurimeve shoqerore ne vleren 1,813,538 leke apo masen 14,5% ka ndodhur** per te njejtat arsye te cilat kane ndikuar ne mosrealizimin e shpenzimeve per paga ,Mosplotesim I organikes me numrin e punonjesve te planifikuar ne momentin e miratimit te buxhetit per vitin 2018 . realizuar

Mosrealizimi I shpenzimeve operative ne masen 16,7% apo ne vleren 6,214,723 leke si rezultat I kursimit te fondeve ne disa raste midis fondit limit dhe ofertes fituese sic eshte rasti I sherbimit I kontrates per blerje goma + pjese xhenrike ne vleren 145 mije leke . Moslikujdimin e faturave per

materialet promovuese per pjesmarrjet ne panaiet kombetare e planifikuar ne vleren 500 mije leke , organizimi I festes se mjalitit ne vleren 700 mije leke si dhe ekzekutimi I vendimeve gjyqesore ne vleren 1,575 mije leke si rezultat I vendosjes se limitit te shpenzimeve nga Ministria e Finances gjate muajve nentor-dhjetor 2018 .Realizimi I shpenzimeve per pritje percjellje vetem 6% e vleres se planifikuar apo 188 mije leke me pak.Mosrealizimi I shpenzimeve te planifikuar per regjistrimin e pasurive te bashkise prane zyres vendore te regjistrimit ne vleren 1,440 mije leke .Mosrealizimi I shpenzimeve per blerje program per financen ne vleren 50 mije leke , moslikujdim I shpenzimeve per blerje kartolina e calendar ne vleren 150 mije leke si dhe diferenca te tjera te vogla ne shpenzimet e planifikuara

3. Mosrealizimi me I madh sic shihet edhe nga tabela me sipër është për zerin investime ne vleren 24,651,925 leke apo ne masen 44% për arsytet si më poshtë :
 - Moslikujdimi I investimit me objekt “ Azhornim per regjistrim fillestar te zones kadastrale te fshatit Qarrisht , Njesia Qender “ne vleren **2,455 mije leke** , pasi kontrata per kete objekt është lidhur me 24.08.2018 dhe afati I saj është 6 muaj nga data e nenshkrimit . Nga ana e operatorit fitues nuk është paraqitur asnje situacion apo fature per likujdim deri me 31.12.2018.
 - Mosrealizim I procedures se prokurimit brenda vitit 2018 per per objektin “Rikonstruksion I ambulances Gurshpate “ ne vleren **449 mije leke** .
 - Mosrealizim I procedures se prokurimit me objekt “Krijim I simbolit zyrtar te Bashkise “ brenda vitit 2018 ne vleren **300 mije leke** .
 - **Mosrealizim I procedures se prokurimit per objeektin “** Vendorsje tabele treguese - orientuese (hyrje + dalje) qyteti” ne vleren 500 mije leke .
 -
 - Moslidhja e kontrates ne vleren **5,000 mije** leke brenda viti 2018 per investimin me objekt “Studime –Projektime,
 - Realizimi I fondit te planifikuar per mbikqyrje dhe kolaudime per investimet e viti 2018 është vetem **1,382 mije leke** nga **8,000 mije** te planifikuara si rezultat I moslikujsimi te te gjitha kontratave te lidhura per mbikqyrje e kolaudime per efekt te vendosjes se limitit te shpenzimeve nga Ministria e Finances .
 - Mosrealizim I shpenzimeve per shpronësime , oponence e leje mjedisore ne vleren e planifikuar prej 1,500 mije leke .

Me poshte po japim te detajuara tabelen e shpenzimeve operative dhe tabelen e investimeve per programin “Planifikim ,Administrim” realizuar gjate vitit 2018

**TABELA E SHPENZIMEVE OPERATIVE
PER PROGRAMIN ADMINISTRIM PLANIFIKIM PER VITIN 2018**

Ne 000/Leke

Nr.	Emërtimi i objektit	Plan	Fakt	Difer. + -	%
1	Shpenzime per energjine ,Ndricimi rrugor	10,000	10,000	-	99.5
2	Shpenzime per ujesjellesin	700	693	7	99.1
3	Shpenzime per internetin	510	466	44	91.3
4	Shpenzime telefonike	307	273	34	88.8
5	Shtypshkrime (letra me vlere)	200	83	117	41.6
6	Kancelari (bojra+ Leter)	1,350	1,323	27	98.0
7	Siguracion makinash, ndertesash	1,300	693	607	53.3
8	Shpenzime per posten	3,300	3,259	41	98.7
9	Dieta	700	694	6	99.1
10	Regjistrim I pasurive ne ZRVP e te tjera me institucionet shteterore	1,500	56	1444	3.7
11	Keshilltare + Kryepleq +shperblime sport+ shperblime amatorresh	6,151	5,915	236	96.2
12	Egzekutim Vendime Gjyqesore	5,000	3,425	1575	68.5
13	Karburant	1,958	1,958	0	100.0

14	Goma +pjese xhenerike ,mirbajtje mjetesh	700	555	145	79.3
15	Kontribut I shoqates se Bashkive	308	308	0	100.0
16	Larje e automjeteve te Bashkise	100	80	20	80.0
17	Blerje kartolina e kalendar	150	-	150	0.0
18	blerje fishek zjarre	50	42	8	84.0
19	Blerje uniforme policia bashkiake,perparese per sek ushqim e kontrollit	55	33	22	60.7
20	blerje pisje per sherbimin veterinar	25	23	3	90.0
21	Shpenzime pritje percjellje	200	12	188	6.0
22	Hostimi I faqes internetit	31	30	1	96.8
23	Materiale promovuese per pjesmarrje ne panaiet kombetare	500	-	500	0.0
24	Organizimi i Festes se mjaltit	700	-	700	0.0
25	Sherbime mirmbajtje per paisjet elektronike	200	46	154	23.2
26	blerje ngrohes elektrik	25	2	24	6.0
27	Blerje program kompjuteri per financen	50	-	50	0.0
28	fatura te pa likujduara	1,213	1,101	112	90.7
	TOTALI	37,285	31,070	6,215	83.2

Pra sic shihet edhe nga tabela e shpenzimeve operative e detajuar me zera si me siper ne asnje rast nuk kemi tejkalim te zerave te planifikuar me buxhetin e vitit 2018 .Ne perputhje me Ligjin e buxhetit gjate vitit 2017 eshte bere rishperndarje fondesh ne 1 rast ne vleren 180,000 leke per shpenzime te paplanifikuara ne buxhet ne fillim te vitit , shpenzime te domosdoshme per t'u kryer .

Gjithashtu ne kete program buxhetor per vitin 2018 eshte perfshire dhe pagesa e bursave te studenteve te vitit te pare te shkollave te larta .Keshthu per vitin 2018 eshte bere pagesa e 51 studenteve me ½ burse ne muaj , ne nje vlere prej 2,165,000leke ose 100 % e planit vjetor .Pagesa eshte bere per periudhen tetor 2017-qershor 2018 ,periudhe e cila perkon me vitin akademik 2016-2017

Nje ze tjetër I planifikuar ne buxhetin e vitit 2018 ne programin buxhetor planifikim , menaxhim administrim eshte dhe zeri I fondit rezerve dhe emergjencave civile , fond ky I cili perdoret me vendim te keshillit te bashkise.

Emergjencat civile

Per periudhen janar- dhjetor 2018 realizimi pere mergjencat civile eshte 1,219,504 leke ose 23 % e planit vjetor .

Fondi rezerve

Per vitin 2018 fondi rezerve I planifikuar ne buxhetin fillestar ka qene 22,635,000 leke dhe ne fund te vitit fondi rezerve I paperdorur paraqitete ne vleren 910,040 leke

Per periudhen vitin 2018 perdorimi I fondit rezerve gjithmone eshte bere me Vendime te Keshillit te Bashkise ,jane marre gjithsej 15 vendime te Keshillit te bashkise per perdorimin e fondit rezerve me nje vlere totale prej 21,724,960 leke

Perdorimi I fondit rezerve paraqitet si me poshte :

Nr.rendor	Emertimi I perdorimit te fondit rezerve	Nr.vendimit	Data	Vlera
1	Ndihme financiare per z.Besim RRupulli		20.01.2018	100,000
2	Bursat per studentet viti 2017-2018	16	20.02.018	2,065,500
3	Investime ne kanalet vaditese	22	20.02.2018	9,687,140
4	Krijimi I simbolit zyrtarr te Bashkise	44	30.04.018	300,000
5	Transport I mbetjeje urbane	63	21.05.018	1,736,017
6	Ndihme financiare z,Naim Qoshku	47	30.04.018	100,000
7	Transferim foni per thirrjen e pare te ReLOAD	45	30.04.018	567,756
8	Blerje pleh kimik per fushen e sportit	69	25.06.018	496,800
9	Bashkefinancim per investimin ne shk.e mesme Lunik	76	25.06.018	3,538,143
10	Bashkefinancim per shkollen e mesme Hotolisht	76	25.06.018	2,823,640
11	Ndihme financiare z.Dylber Alla	73	25.06.018	30,000
12	Bashkefinancim per investimin me Word Vision	89	27.08.018	159,964
13	Dhenie Ndihme financiare zj.Bukurie Bici	97	27.08.018	20,000
14.	Mbulimin e shpenzimeve te varrimit per Martin Zenelin	12	24.09.018	70,000
15.	Dhenie ndihme financiare z.Kastriot Zylali	124	26.10.018	30,000
	Fondi rezerve I perdorur deri me 31.12.018			21,724,960

Plani vjetor I Fondit rezerve 2018
Gjendje pa perdorur me 31.12.018

22,635,000 leke
910,040 leke

Investimet e planifikuara dhe te realizuara ne programin buxhetor planifikim , menaxhim administrim me burime financimi nga transferta e pakushtezuar , te ardhurat dhe te ardhurat e trasheguara per vitin 2018 jepen ne tabelen si me poshte :

Nr	Lloji I investimit	Nga Tr. Pakusht.	Nga te Ardhurat	Nga te ardh. e trasheg.	Totali 2018	Likujduar 2018	Komente
1.	Rikonstruksion I Ambulances Gur - Shpate, N.A.Polis	448,995			448,995	0	Nuk eshte prokuruar
2.	Rikonstruksion I fasades se pallatit nr. 12, Bashkia Librazhd	3,086,836			3,086,836	2,840,923	Perfunduar

3.	Krijimi I simbolit te ri zyrtar te Bashkise	300,000			300,000	0	Pa realizuar
4.	Azhornim per regjistrim fillestar te zones kadastrale te fshatit Qarrishte, Nj.A.Qender	2,476,260			2,476,260		Lidhur kontrata ne fund te dhjetorit me afat zbatimi 1 vit
5.	Mbrojtje e tokes bujqesore	1,000,000			1,000,000		Ne process likujdimi
6.	Blerje materiale per ndertim dhe mirembajtje hapësirash midis pallatesh	678,049			678,049		Pa likujduar per efekt limiti
7.	Vendosje table treguese - orientuese (hyrje + dalje) qyteti	500,000			500,000		Nuk eshte prokuruar
8.	Studim, oponence dhe leje mjedisore	500,000			500,000		Nuk ka pasur per vitin 2018
9.	Shpronësime	1,000,000			1,000,000		Nuk ka pasur
10.	Blerje pajisje elektronike	1,000,000			1,000,000		Pa likujduar per efekt te limitit
11.	Blerje pajisje zyresh	600,000			600,000	599,280	Realizuar
12.	Studime-Projektime	5,000,000			5,000,000		Prokuruar ne fund te dhjetorit
13.	Instalim e blerje kamerash per objektet shkollore te qytetit ,cerdhet ,kopshtet , rruget kryesore e kryqezimet e qytetit	1,509,375			1,509,375		Prokuruar ne fund te dhjetorit
13.	Mbikqyrje - kolaudim te projekteve te zbatimit te vitit 2018		8,000,000		8,000,000	1,382,145	Likujduar pjeserisht
14.	Projektime			4,259,920	4,259,920	4,259,920	Likujduar
15.	Blerje paisje elektronike			416,300	416,300	416,300	Likujduar
16.	Mbikqyrje - kolaudim te projekteve te zbatimit te viteve te meparshme			7,396,545	7,396,545	7,385,311	Likujduar
17.	“Shtese Rikonstruksion I rrugeve rurale te Bashkise librazhd viti 2017”			4,240,807	4,240,807	4,028,767	Perfunduar
18.	Ndertimi I ures se lagjes Liqejthi Babje , ura ne rrugen Prevall-Dranovice , Ura dhe rik.i rruges se lagjes Llange ,Ndertim ure Drapata ,Ndertim ura e Galanonit			1,855,397	1,855,397	1,762,627	Perfunduar
19.	Instalimi I sistemit per administrimin e taksave dhe tarifave vendore			1,260,000	1,260,000	948,000	Perfunduar
20.	Riparim I ujesjellesave Orenje dhe sistemi vadites Neshte			330,858	330,858	330,858	Perfunduar
21.	Perforcim te kembeve dhe mureve mbeshtetese te ures Dranovice			1,483,916	1,483,916		

	-Kostenje “					1,409,720	Perfunduar
22	“Rikonstrukcion i pusetes shkarkuese te rezervuarit Vehcan ,Njesia administrative Hotolisht”			158,000	158,000	0	Nuk eshte prokuruar
23	Projektime			2,720,000	2,720,000	2,720,000	Likujduar
24.	Rruga Kotorice -Dragostunje ,ndertimtrase rruga e krrabes , ,rruga Dranovice -Kostenje ,hapje rruge gurakuq -rinas 1 km			4,355,736	4,355,736		Perfunduar
25.	Rikonstrukcion Rruges Prevall-Dranovice			1,194,928	1,194,928	0	Trasheguar nga ish komunat
26.	Rikonstrukcion I rruges Lunik-Qender			299,718	299,718	0	Trasheguar nga ish komunat
	Totali	18,099,515	8,000,000	29,972,125	56,071,640	31,419,715	

Pra sic jepet ne tabelen me siper realizimi I investimeve per programin buxhetor , planifikim , menaxhim administrim eshte ne vleren 31,419,715 leke leke ose ne masen 56 % e planit vjetor .

Disa nga problemet e konstatuara per vitin 2018 per kete program buxhetor :

- Mosplotesim I organikes me numrin e planifikuar te punonjesve duke sjalle ne kete menyre mosrealizim te fondit te pagave dhe sigurimeve shoqerore ne nje vlere prej 14,065 mije leke .
- Mosprokurimi I disa prej objekteve te planifikuara ne vleren 2,749 mije leke ,
- Lidhja e kontratave ne fund te muajit dhjetor gje qe sjell likujdimin e tyre ne vitin pasardhes , duke ulur ne kete menyre realizimin e buxhetit te planifikuar .
- Moslikujdim I investimeve per efekt te vendosjes se limitit te shpenzimeve nga Ministria e Finances .
- Moslikujdim I investimeve te trasheguara nga ish Komunat per efekt mungese ne dokumentacion .

SHERBIMET PUBLIKE

Ashtu sic percaktohet dhe ne Ligjin Nr.139 Date 17.12.2015 “Per Vetqeverisjen vendore “ ne fushen e infrastructures dhe sherbimeve publike , bashkite jane pergjegjese ne territorin e juridiksionit te tyre per :

1. Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm.
2. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.
3. Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara.
4. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.
5. Ndriçimin e mjediseve publike.
6. Transportin publik vendor.
7. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit.
8. Shërbimin e dekorit publik.
9. Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.
10. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.
11. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.
12. Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.
13. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
14. Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar.

Per realizimin e te gjitha ketyre sherbimeve te percaktuara me ligj Bashkia Librazhd ka organizuar Agjencine Puneve publike e organizuar ne dy sektore sherbimesh jane Ndermarrja e Sherbimeve dhe Gjelberimit dhe Ndermarrja e rrugeve rurale

• **NDERMARRJA E SHERBIMEVE DHE GJELBERIMIT**

eshte pergjegjese per mirmbajtjen e parqeve dhe hapësirave publike , gjelberimin , dekorin publik , ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, garantimin e shërbimit publik të varrimit, mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore, Ndrichimin e mjediseve publike

Realizimi I shpenzimeve per ndermarrjen e sherbimeve dhe gjelberimit si per sherbimin e pastrimit per vitin 2017 jepet ne tabelen si me poshte :

Nr.	Emertimi I shpenzimeve	Plani 2018	Fakti 2018	Realizimi ne %	Nr.i punonj.sipas V.K.B.	Nr. I punonj. Te paguar
I.	Shpenzime per pagat				32	32
a.	Nga Transferta e Pakushtezuar	14,295,000	11,596,176	81		
b.	Ng ate ardhurat					
c.	Ng ate trasheguarat					
	Totali I (Pagat)	14,295,000	11,596,176	81		
II.	Shpenzime per sig.shoqerore				32	32
a.	Nga Transferta e Pakushtezuar	2,274,000	1,840,852	80,9		
b.	Nga te ardhurat					
c.	Nga te trasheguarat					
	Totali II. (Sig.shoqerore)	2,274,000	1,840,852	80,9		
III.	Shpenzime operative					
a.	Nga Transferta e Pakushtezuar	13,287,912	2,308,157	17,4		
b.	Nga te ardhurat					
c.	Nga te trasheguarat	17,271,088	17,271,088	100		
	Totali III (shpenzime operative)	30,559,000	19,579,245	64		
IV.	Investime					
a.	Nga Transferta e Pakushtezuar	4,500,000	4,500,000			
b.	Nga te ardhurat e trasheguara	158,462	132,033			
	Totali IV	4,658,462	4,632,033			
	TotaliI+II+III+IV	51,786,462.0	37,648,306.0	73		

Pra sic shihet realizimi i buxhetit per vitin 2017 per ndermarrjen e sherbimeve dhe gjelberimit eshte 37,648,306 leke ose 76,8 % e shpenzimeve totale te planifikuara per vitin 2018 .

Mosrealizimi ne masen 27% apo ne vleren 14,138,156 leke leke ka ardhur si rezultat i disa faktoreve :

Mosplotesimi qe ne fillim te vitit te organikes me numrin e punonjesve te miratuar per vitin 2018 Mosshperndarja e fondit te vecante per vitin 2018 , planifikuar ne masen 5% te fondit total te pagave ne vleren .2,698,824 leke Numri i

punonjesve te planifikuar per kete ndermarrje me V.K.B. Nr.110 date 29.12.2017 ka qene 32punonjes .Realisht per vitin 2018 jane paguar mesatarisht 32 punonjes .Mosplotesimi i organikes me numrin maksimal te punonjesve te planifikuar qe ne fillim te vitit ka sjelle dhe mosrealizimin e fondit te pagave dhe sigurimeve shoqerore ne vleren 3,131,972 leke .

Realizimi i shpenzimeve operative paraqitet ne vleren 19,579,245 leke apo masen 64 % . Mosrealizimi prej 36% ka ardhur si rezultat I moslikujdimit te faturave te krijuara ne periudhen tetor -2018 , si rezultat I vendosjes se limitit te shpenzimeve nga ana e Ministrise se Finances

Gjithashtu per vitin 2018 jane planifikuar investime ne vleren 4,658,462 leke te cilat jane realizuar ne vleren 4,658,462 leke apo ne masen 100% .Investimet e realizuar nga kjo ndermarrje kane te bejne kryesisht me investimet ne blerjen e nje mjete te ri per nevojat e ndermarrjes .

Investimet e reralizuara nga kjo ndermarrje per vitin 2018 jepen ne tabelen si me poshte :

Nr	Lloji I investimit	Nga Tr. Pakusht.	Nga te Ardhurat	Nga te ardh. e trasheg.	Totali 2018	Likujduar 2018	Komente
1.	Blerje kamioni vetshkarkues per Agjencine e Puneve Publike	4,500,000			4,500,000	4,500,000	Likujduar marre ne dorezim
2.	Blerje material per objektin : "Ndertim I kanaleve te ujrave te zeza ,Lagja Dragostunje (ish grumbullimi) "			158,462	158,462	158,462	Likujduar
	Totali	4,500,000		158,462	4,658,462	4,658,462	

Sherbim tjetër qe ofrohet nga Bashkia Librazhd eshte edhe sherbimi i Pastrimit , qe perben dhe nje nga funksionet e veta te vetqeverisjes vendore , te percaktuar qarte dhe ne ligjin organik te vetqeverisjes vendore .

Per vitin 2018 fondi i planifikuar per sherbimin e pastrimit te Bashkise dhe qendrave te njesive administrative eshte ne vleren 18,362,000 leke .Realizimi per vitin 2018 eshte 15,957,925 leke ose 87 % e planit vjetor . Realizimi i buxhetit per kete sherbim eshte ne kete mase pasi nga ana e subjektit nuk eshte paraqitur prane Bashkise Librazhd fatura e sherbimit per muajin nentor 2018 , prandaj dhe realizimi eshte ne masen 87%

Realizimi i buxhetit per shpenzimet e pastrimit paraqite ne tabelen si me poshte :

Nr.	Emertimi I shpenzimeve	Plani 2018	Realizimi 2018	Realizimi ne %
1.	Nga Transferta e pakushtezuar	15,990,608	13,843,857	86,5
2.	Ng ate Ardhurat	2,371,392	2,114,068	89,1
3.	Nga te Trasheguarat			
	TOTALI	18,362,000	15,957,925	87

Nepermjet realizimit te ketij sherbimi I kemi ofruar qytetareve nje qytet me te paster dhe me te shendetshem .

Keshtu mesatarisht nga ky sherbim jane kryer keto sherbime ne muaj :

Fshirje rruge me punetore me krahe	1,529,150	m2 rruge
Zbrazje konteniери dhe largim I mbetjeve urbane	3, 379	konteniери
Larje e disenfiktimit I konteniериeve te mbetjeve urbane	1590	konteniери

Nje tjetër sherbim I rendesishem qe ofrohet nga Bashkia Librazhd , per permirsimin e cilesise se jetes se komunitetit eshte dhe transporti I mbetjeve urbane ne incineratorin e perpunimit te mbetjeve urbane prane Metalurgjikut Elbasan , nje sherbim tejet I rendesishem me ndikim direkt ne mjedis dhe ne jeten e komunitetit .

Per vitin 2018 jane vene ne dispozicion nga buxheti I Bashkise per kete sherbim 1,736,017 leke .Realizimi per vitin 2018 eshte zero pasi nga ana e operatorit nuk jane paraqitur faturat dhe situacionet per likujdim .Likujdimi I faturave te palikujduara per vitin 2018 eshte bere gjate muajit shkurt 2019 ne vleren 1,403,394 leke .Per periudhen Korrik-Dhjetor 2018 ne baze te situacioneve jane transportuar gjithsej 1172 ton mbetje urbane .

Disa nga problemet e konstatuara per vitin 2018 per kete program buxhetor :

- Mosplotesim I organikes me numrin e planifikuar te punonjesve te ndermarrjes se sherbim-gjelberimit duke sjelle ne kete menyre mosrealizim te fondit te pagave dhe sigurimeve shoqerore ne nje vlere 3,131,972 leke
- Moslikujdimi ne kohe I faturave per efekt te vendosjes se limitit te shpenzimeve
